

**UDHËZIM**  
**Nr. 14, datë 27.5.2019**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR  
PËRGATITJEN DHE LËSHIMIN E KARTËS SË STUDENTIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 100, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 226, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen më çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”,

**UDHËZOJ:**

1. Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit, në vijim karta, e cila përbën një dokument unik identifikues që i shërben studentit për të përfituar shërbime, me çmime të reduktuara, nga entet shtetërore në fushën e artit dhe kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes.

2. Të drejtën e pajisjes me kartë e ka çdo individ që gëzon statusin e studentit. Karta humbet vlefshmërinë dhe duhet të dorëzohet menjëherë me marrjen e diplomës të programit përkatës të studimit apo në rastet kur individ i humbet statusin e studentit.

3. Studenti mund të përfitojë kartën në momentin e pajisjes me Numër Identifikues Matrikullimi (NIM) nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

4. Studenti e përdor kartën deri në momentin që do të pajiset me diplomë të ciklit përkatës të studimit.

5. Aplikimi për kartë bëhet nga vetë studentin në IAL-në përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

6. Karta përmban elemente të dukshme dhe të padukshme sipas përcaktimeve të shtojcës 1 pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

7. Karta lëshohet për të gjithë kohëzgjatjen normale të studimeve. Në rast dëmtimi apo kur studentin e humbet atë, studentin ka të drejtë të riaplikojë për një kartë të re, e cila lëshohet me të njëjtin afat vlefshmërie sa karta e parë.

8. Studentin që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes normale të programit përkatës të studimit, ka të drejtë të riaplikojë për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së kartës, pas miratimit të zgjatjes së afatit nga IAL-ja përkatëse.

9. Me pezullimin apo largimin e studentit nga IAL-ja, sekretaria e IAL-së përkatëse duhet t'i tërheqë kartën e studentit, të kryejë brenda ditës procedurat e çregjistrimit, me qëllim asgjësimin e saj.

10. Procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës ndiqen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur prodhimi dhe administrimi i kartës së studentit i delegohet njësisë së vetëqeverisjes vendore, procedura përkatëse për përgatitjen dhe lëshimin e saj, përcaktohen në marrëveshjen dypalëshe të nënshkruar për këtë qëllim.

11. Baza e të dhënave që krijohet gjatë procesit të pajisjes me kartën e studentit administrohet nga ministria përgjegjëse për arsimin përmes Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Në rastet kur prodhimi dhe administrimi i kartës së studentit i delegohet njësisë së vetëqeverisjes vendore, baza e të dhënave i vihet në dispozicion ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore nëpërmjet krijimit të aksesit të përhershëm ashtu dhe transferimit të të dhënave në mënyrë të vazhdueshme.

12. Për pajisjen me kartë, studenti duhet të paraqitet personalisht pranë sporteleve të hapura për këtë qëllim dhe duhet të jetë i pajisur me kartën e identitetit.

13. Studenti duhet të plotësojë një formular vetëdeklarimi, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

14. Karta printohet pasi bëhet verifikimi në sistem i të dhënave të studentit. Tërheqja e kartës bëhet pranë IAL-ve nga vetë studenti.

15. Institucionet apo subjektet e kontraktuara prej tyre, për realizimin, përgatitjen dhe lëshimit të Kartës, duhet të pajisin të gjithë IAL-të me bazën materiale të nevojshme (shtojca 1), sipas ngarkesës së studentëve dhe të trajnojnë personelin që do punojnë për kryerjen e këtij procesi. Institucionet apo subjektet e kontraktuara prej tyre, mund të kontraktojnë studentë të IAL-së përkatëse, të punësuar me kohë të pjesshme, për realizimin e përgatitjes dhe lëshimit të kartës.

16. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

**Besa Shahini**

#### SHTOJCA NR. 1 UDHËZUESI TEKNIK

Ngritja e një sistemi për regjistrimin e studentëve që do të pajisen me kartë sipas të dhënave të përcaktuara si më poshtë:

a) Elemente të dukshme të kartës:

1. Logo e MASR, logo e IAL-së,
2. Logo e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas marrëveshjeve, dhe sipas rastit;
3. Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë (IAL);
4. Fotografia e studentit;
5. Emri;
6. Mbiemri;
7. Numri i matrikullimit;
8. Kodi QR i identifikimit;
9. Afati i vlefshmërisë së Kartës;
10. Numri i kartës.

b) Elementet e padukshme të kartës, janë:

1. Emërtimi i njësisë kryesore;
2. Emërtimi i programit të studimit;
3. Cikli i studimit;
4. Data e regjistrimit në programin përkatës të studimit;
5. Datëlindja e studentit;
6. Numri i kontaktit;
7. Adresa e e-mail-it.

c) Struktura fizike e kartës së studentit:

Karta duhet të jetë plastike, material PVC me përmasa 85 mm x 55mm dhe trashësi 0.8 mm.

Karta duhet të jetë e pajisur me elementet e nevojshme në mënyrë që të njihet nga qendrat POS, gjithashtu, dhe kod QR që të jetë e identifikueshme elektronikisht.

Ngritja e sporteve bëhet pranë çdo njësie kryesore me qëllim pajisjen e studentëve me kartë. Sistemi do të jetë i aksesueshëm në të gjitha këto sporte.

Në momentin e paraqitjes së studentit do të plotësohet skeda e shoqëruar me të dhënat e përcaktuara dhe në këtë moment do të kryhet dhe fotografimi direkt i studentit.

Pjesë e softit që do të ndërtohet është kompozimi automatik i kartës dhe printimi i saj në moment, sipas të dhënave të plotësuara.

**Baza materiale:**

Pikat e shpërndarjes së kartës pranë fakulteteve dhe universiteteve do të kenë:

- soft i personalizuar;
- kompjuter;
- printer i posaçëm për printimin e kartave;
- kamera fotografike e lidhur me kompjuterin;
- lexues dhe aktivizues i kartës.

SHTOJCA NR. 2

FORMULARI MBI KUSHTET E PRIVATËSISË PËR PAJISJEN ME KARTËN E STUDENTIT

\* EMRI

\* MBIEMRI

Me këtë anëtarësim pranoj që të dhënat e mia personale të përdoren për t'u informuar për mundësitë dhe avantazhet që lidhen me përdorimin e kartës.

Pranoj  Nuk pranoj

Pranoj të marr <b>Kartën e Studentit</b>	
Data (dd/mm/vvvv) <input type="text"/>	<input type="text"/> Firma

- Të dhënat e treguara nga zotëruesit e kartës së Studentit, do të përfshihen në arkivin elektronik të institucioneve të arsimit të lartë dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore në rastin kur këto të fundit kanë marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për realizimin dhe shpërndarjen e kartës.

- Këto të dhëna klasifikohen si të dhëna personale, referuar ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe do të mblidhen me qëllimin për të realizuar iniciativa publicitare, të posaçme për mbajtësit e Kartës së Studentit, si dhe për t'i informuar në çdo kohë, me anë të mjeteve të ndryshme të komunikimit, për mundësitë dhe avantazhet që lidhen me përdorimin e kartës.

- Këto të dhëna do të përpunohen nga punonjësit dhe bashkëpunëtorët e institucioneve të arsimit të lartë dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore në rastin kur këto të fundit kanë marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për realizimin dhe shpërndarjen e kartës.

- Të anëtarësuarit duhet të vihen në dijeni se të dhënat e tyre përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe se ata kanë të drejtë të njihen me të dhënat e tyre personale, të kërkojnë korrigjim ose fshirje, si dhe të

kundërshtojnë përdorimin e tyre, duke kontaktuar me përgjegjësit e përpunimit dhe duke i bërë të ditur mënyrën e kontaktimit me këto përgjegjës.

- Të gjitha këto të drejta do t'i bëhen të ditura përdoruesve të kartës, në momentin e nënshkrimit të kartës së Studentit, ku do të jenë të pasqyruara sa më sipër dhe me anë të të cilit do të kërkohet autorizim për mbajtjen dhe përpunimin e këtyre të dhënave.